



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 39

Prishtinë, më 12 mars 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N- 10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Behar Selimi, Mufera Şinik, Halit Krasniqi, Haki Demolli, Albulena Haxhiu, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Amir Ahmeti dhe Jasmina Zhivković.

Munguan: Arben Gashi dhe Arsim Bajrami.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Jeton Bytyqi – OSBE; Etrur Maloku – US Embassy; Lejla Selimi – OSBE; Artan Canhasi –EULEX; Flutura Kusari – EULEX; Rexhep Gashi – ekspert; Lumniçe Murati – ZPRK; Sefadin Blakaj – SEAD/USAID;

Mirgeta Hajdari, Saranda Pajaziti, Eroll Gashi, Visar Bikliqi, Liridon Doberdolani, Fjolla Krasniqi dhe Fitore Sadiku – praktikantë.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Behar Selimi - nënkryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 06.02.2012;
3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të grupit të punës në Projektkodin penal të Republikës së Kosovës;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat nr. 03/L-222;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-80 për lojërat e fatit;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-094 për shërbimet e shoqërisë informatike;
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L – 97 për bibliotekat në Republikën e Kosovës;

8. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-83 për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkesve;
9. Shqyrtimi i Përfundimit të Kryesisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës;
10. Njoftim lidhur me raportin e Avokatit të Popullit lidhur me ngjarjet në protestat e datës 14 dhe 22 janar 2012;
11. Shqyrtimi i strategjisë dhe Planit të veprimit kundër korrupsionit për vitin 2012-2016;
12. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 06.02. 2012

Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 06. 02. 2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të grupit të punës në Projektkodin penal të Republikës së Kosovës

Kryesuesi - Paraqiti arsyetimin për propozimamendamentet e grupit të punës, duke vlerësuar interesimin e të gjithë faktorëve rreth këtij Projektkodi: angazhimin e deputetëve, shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare dhe ekspertëve. Ai Sqaroi se propozimamendamentet kanë ardhur nga dy ministri, ajo e Punëve të Brendshme, të cilat janë paraqitur në kohën e paraparë dhe amendamentet e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të cilat nuk e kanë respektuar afatin e përcaktuar me Rregulloren e punës. Sa i përket Ministrisë së Punëve të Brendshme, përfaqësuesit e saj kanë propozuar amendamentin për veprën penale, i cili do të paraqitet pas liberalizimit të vizave, pra kur të jemi pjesë e zonës Shengen. Esencialisht, ky amendament i propozuar nuk i bën dëm dhe mendoj se është mirë të jetë pjesë e Kodit Penal.

Armend Zemaj- Theksoi se në parim, pajtohem që mund të kemi një amendament të caktuar që e përcakton si vepër penale keqpërdorimin e vizave, por më duket si propagandë që mund të jetë e kuptimit të mirë, por nuk mendoj se ka diçka konkrete, ka mungesë përmbajtjesore, si dhe në cilin nen do të futet kjo vepër penale, propozimi im është që kjo pikë të shtyhet.

Kryesuesi- Sqaroi se propozimi i Ministrisë kryesisht ka të bëjë me kontrabandën me emigrantë, duke ju ndihmuar shteteve të treta që nuk janë pjesë e BE-së. Ky nen do të ishte një lloj garancioni se ne nuk pretendojmë ta keqpërdorim liberalizimin e vizave.

Albulena Haxhiu- Ky propozimamendament është veç shpresë rreth liberalizimit, ka punë të tjera të cilat duhet të kryhen më herët. Propozoi që kjo pikë të shtyhet në mbledhjen e radhës.

Ardian Gjini- Nëse është kërkesë e Komisionit Evropian për liberalizimin e vizave, atëherë nuk do të ishte e arsyeshme që ky Komision të ndikojë në ndonjë mënyrë që ky proces të ngadalësohet. Nuk është mirë të hidhet poshtë ky propozim. Ne si pozitë dhe opozitë, nuk duhet të kemi fërkime në këto tema. Propozoi që në mbledhjen e radhës të diskutohet për këtë çështje, pasi që kemi mundësi për studim dhe konsulta dhe do të kemi një qëndrim më të qartë.

Haki Demolli- U pajtua me parafolësin, që sa i përket amendamentit të propozuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, të mos ngutemi para se të kemi një shpjegim dhe interpretim nga propozuesi, sepse nga kjo që kemi përpara nuk e kam shumë të qartë. Në qoftë se është një formë e rëndë e kontrabandës njerëzore, ne duhet t'i gjejmë vendin adekuat.

Amir Ahmeti -Po shihet qartë insistimi i Ministrisë për këtë çështje, pasi që Kosova ka qenë pikë transite për në Evropë. Kjo ndoshta vjen si pasojë e kësaj që të kemi një lloj sigurimi se nuk do të ketë keqpërdorim të vizave. Mendoj se duhet të konsultohemi dhe të vendosim se në cilën pjesë do të vendoset ky amendament.

Halit Krasniqi - U pajtua me parafolësit që kjo çështje të shtyhet për arsye parimore dhe politike, pra për një frymë demokratike të debatit, që vendimi të merret me konsensus. Amendamenti ka arsyetim shumë të mirë, vepra penale do të ekzistojë dhe kjo bazë duhet të rregullohet me ligj, sepse nga praktika, ka shtete që kanë rrezikuar vendin e tyre në Bashkimin Evropian, për shkak se nuk e kanë rregulluar këtë lloj të kontrabandës me njerëz ose nuk kanë arritur ta zbatojnë ligjin në mënyrën që kërkohet.

Pas një diskutimi që u zhvillua dhe me propozimet e dhëna që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës, Komisioni vendosi që amendamentet e grupit të punës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të diskutohen dhe të miratohen në mbledhjen e radhës.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat nr. 03/ L-222,

Administrata e Komisioni, dhanë sqarime se Projektligji nr. 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat nr. 03/ L-222 dhe amendamentet e propozuara, janë në kundërshtim me Ligjin e procedurës administrative, Ligjin për konfliktet administrative dhe Ligjin për gjykatat.

Ardian Gjini- Theksoi se Administrata është ajo që jep mendimin e saj profesional dhe kërkoi që arsyetimet e dhëna t'i paraqesin në formë të shkruar në mbledhjen e radhës. Propozoi që kjo çështje të shtyhet në mbledhjen e radhës.

Halit Krasniqi - Theksoi se nuk më pëlqen fakti që nuk jemi të njoftuar më herët, sepse kryetari nuk është konsultuar me nënkryetarin, në këtë rast ne jemi në një lloj lajthimi, pra në konflikt me vetveten.

Albulena Haxhiu- Kryetari duhet të koordinohet me nënkryetarin, po ashtu edhe ne duhet të jemi të informuar me kohë.

Armend Zemaj- Nuk pajtohem as me administratën, as me Halitin, sepse ky Ligj ka kaluar në lexim të parë, që do të thotë se këto vërejtje do të duhej të ishin bërë më herët. Është e vërtetë se shqetësimi është ngritur edhe në esencën plenare që riorganizimi do të jetë sfidë për të gjithë ne.

Kryesuesi- Kërkoj që kjo pikë të shtyhet në mbledhjen e radhës dhe kërkoj nga administrata që t'i paraqesë me shkrim vërejtjet që u ngritën gjatë mbledhjes.

Komisioni vendosi që kjo pikë të shqyrtohet në mbledhjen e radhës.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-80 për lojërat e fatit

Kryesuesi- Paraqiti për shqyrtim Projektligjin për lojërat e fatit dhe amendamentet e propozuara dhe kërkoj nga anëtarët që të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

Albulena Haxhiu- Theksoi se në amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nuk kam ndonjë vërejtje, por amendamentet e Shqipërisë nuk i votoj.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-80 për lojërat e fatit e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-094 për shërbimet e shoqërisë informatike

Kryesuesi- Paraqiti për shqyrtim Projektligjin për shërbimet e shoqërisë informatike dhe amendamentet e propozuara dhe kërkoj nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-094 për shërbimet e shoqërisë informatike, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-97 për bibliotekat në Republikën e Kosovës

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-97 për bibliotekat në Republikën e Kosovës e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

8. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-83 për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuessve

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-83 për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuessve, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

8. Shqyrtimi i Përfundimit të Kryesisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës

Komisioni, e shqyrtoi Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 04-P-073/k, lidhur me propozimin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës dhe vlerësoi se propozimi për emërimin e kandidatëve të përmendur në

pozitat e theksuara, është në pajtim me Ligjin për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale dhe u pajtua që Kuvendit t’ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të emërohen anëtarë të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës:

1. Ujup Krasniqi,
2. Ismajl Osdautaj.

10. Njoftimi lidhur me raportin e Avokatit të Popullit lidhur me ngjarjet në protestat e datës 14 dhe 22 janar 2012

Komisioni u njoftua me raportin e Avokatit të Popullit lidhur me ngjarjet në protestat e datës 14 dhe 22 janar 2012. Lidhur me këtë raport, nuk pati diskutime.

11. Shqyrtimi i strategjisë dhe Planit të veprimit kundër korrupsionit për vitin 2012-2016

Kryesuesi- E paraqiti për votim strategjinë dhe Planin e veprimit kundër korrupsionit për vitin 2012-2016, që të përcillet në seancë plenare. Votimi ishte “për “ 4 dhe “ kundër “ 4 “.

Komisioni ishte i ndarë për të proceduar në seancë strategjinë dhe Planin e veprimit kundër korrupsionit për vitin 2012-2016.

12. Të ndryshme

Armend Zemaj- Kërkoj që për rihartimin e Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, të formohet një grupi i punës, ku do të merrnin pjesë përfaqësuesit e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Komisionit për Integritet Evropian, si dhe deputetët që janë pjesë e nënkomisionit, pasi që janë të përfaqësuar të gjitha subjektet politike. Ai kërkoj miratimin e propozimit nga Komisioni.

Propozimi i kryetarit të Nënkomisionit për Mandate, Imunitet dhe Rregullore të Punës së Kuvendit, u përkrah njëzëri.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetari i Komisionit

Behar Selimi